



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 124/Prot.
5

Tiranë, më 17/03/2021

URDHËR

Nr. 153 datë 17/03 2021

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE TË PEZULLIMIT NGA DETYRA PËR
NOTEREN ALBANA HODAJ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26 gërma “d”, të nenit 53, pika 2, gërma “b” të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, si dhe Vendimit të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr.1/2021, datë 24.02.2021,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.12, datë 08.01.2021, pas shkeljeve të konstatuara nga hetimi i kryer në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.198, datë 26.06.2020 “Për fillimin e hetimit disiplinor pranë noteres Albana Hodaj”, është vendosur nisja e procedimit disiplinor për noteren Albana Hodaj.

Në seancat e datës 19.02.2021 dhe 24.02.2021, Bordi Disiplinor ka marrë në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë sipas Urdhrit nr.12, datë 08.01.2021, “Për nisjen e procedimit disiplinor për noteren Albana Hodaj”.

Shkelja e konstatuar nga Raporti Hetimor, në bazë dhe për shkak të të cilës, Ministri i Drejtësisë ka kërkuar zbatimin e pikës dh), të nenit 26, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit për Noteren Albana Hodaj është: ushtrimi i profesionit të noterit jashtë juridiksionit të bashkisë (Gjirokastrë, e më pas Durrës) përcaktuar me anë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë me nr. 5053/6, dt. 28.06.2006 dhe Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 233, datë 21.04.2014. Kjo veprimtari e Noteres Albana Hodaj nga Ministria e Drejtësisë është vlerësuar si shkelje shumë e rëndë në kuptim të ligjit dhe të urdhrave të mësipërm.

Siç referon Raporti Hetimor dhe fakt i pranuar nga Notere Albana Hodaj, përpara grupit të kontrollit dhe përpara Bordit Disiplinor, gjatë seancës dëgjimore dhe në parashtrimet e dorëzuara me shkrim, që prej datës 21.03.2012, noterja ushtron aktivitetin në Bashkinë e Tiranës, pra jashtë juridiksionit të Bashkisë Durrës, përcaktuar me anë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 233, datë 21.04.2014 (dhe jashtë juridiksionit të Bashkisë Gjirokastrë përcaktuar me Urdhër të

Ministrit të Drejtësisë me nr. 5053/6, dt. 28.06.2006, për periudhën 21.03.2012 deri më datë 21.04.2014).

Bordi Disiplinor pasi ka analizuar me kujdes faktet, bazën ligjore dhe raportin e Ministrisë së Drejtësisë, pasi ka dëgjuar parashtimet e noteres dhe të përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë në seancën dëgjimore, mbështetur në nenin 51 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170, datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”, me vendimin nr.1/2021, datë 24.02.2021 ka vendosur:

1. *Pranimin e kërkesës të Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noteres Albana Hodaj;*
2. *Ndryshimin e masës së propozuar nga Ministri i Drejtësisë sipas gërmës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, në gërmën d) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”;*
3. *Marrjen e masës disiplinore të pezullimit nga detyra e noterit, për noteren Albana Hodaj, për një periudhë 3-vjeçare.*

Me shkresën nr.124/3 Prot., datë 08.03.2021, Bordi Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Noterisë, ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë Vendimin nr.1/2021, datë 24.02.2021.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 26 gërma “d”, të nenit 53, pika 2 gërma “b” të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, si dhe Vendimit të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr.1/2021, datë 24.02.2021,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masës disiplinore të pezullimit nga detyra për një periudhë 3 vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Urdhri, për noteren Albana Hodaj.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj.Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë.
3. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellin emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.
4. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 3, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës, noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 7 ditëve pune.

5. Komisioni i marrjes në dorëzim të arkivës merr në dorëzim me procesverbal vulën e njomë dhe vulën e thatë të noteres me qëllim ruajtjen e tyre në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.
6. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
7. Ndaj këtij urdhri, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
8. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Bankat e nivelit të dytë.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri noteres Albana Hodaj, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe Bordit Disiplinor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Etilda Gjonaj (Saliu)

